



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme pika 10, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT
KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR TË ZHVENDOSURIT DHE ZGJIDHJE TË
QËNDRUESHME

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për monitorimin e zbatimit të Planit Komunal të Veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Radmila Simijanoviq, Zyra Lokale për Komunitete, Kryesuese
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim anëtar
3. Igballe Mulaj, Qendra për Punë Sociale, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që të bëjë monitorimin e zbatimit të Planit Komunal të Veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe lidhur me këtë ti raportojë Kryetarit të Komunës çdo 6 muaj dhe sipas nevojës të jape edhe rekomandimet përkatëse. Komisioni gjatë monitorimit do të bashkëpunoj ngushtë me shoqërinë civile.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 561 - 20576

Lipjan, më 21.04.2017



KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti